



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:042883
Datë: 18.10.2024
Numri i dokumentit: 06317890

Ca.nr.5053/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Enes Mehmeti - kryetar i kolegjit, Burim Shala e Nora Bllaca Dula, anëtar në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.T nga Mitrovica, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Besart Kadriu, avokat në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore - Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti, kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.288/22, të datës 19.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **16.10.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Mitrovicës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Mitrovicë, ndërsa pika I e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.288/22, i datës 19.03.2024, që ka të bëjë me pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditëses, **VËRTETOHET**.

II. Pika **II** e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.288/22, i datës 19.03.2024, që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditëses, *mbetet e pashqyrtuar*.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.288/22, të datës 19.03.2024, ka vendosur “... në pikën I të dispozitivit të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses B.T, nga Mitrovica, detyrohet e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore - Drejtoria e Arsimit, me seli në Mitrovicë, që paditëses në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit, për 600 ditë

gjatë vajtje-ardhjes në punë, në ShFMU “Fazli Graiçevci”, në fshatin Shipol, Komuna e Mitrovicës, për periudhën kohore nga data 02.03.2019, e deri me datë 22.11.2022, t’ia paguajë shumën prej 420.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë të datës 02.03.2022, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 199.00 Euro, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit. Në pikën II të dispozitivit refuzohet kërkesa e të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore - Drejtoria e Arsimit, me seli në Mitrovicë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet paditësja që t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 179.40 euro, në tërësi si e pabazuar....”

Kundër këtij aktgjykimi, ka parashtruar ankesë e paditura përmes përfaqësueses së autorizuar, për shkak të *shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e të paditurës, të ndryshohet Aktgjykimi C.nr.288/22, i datës 19.03.2024 ashtu q’etë refuzohet në tërësi e pabazuar kërkesëpadia e paditëses, apo që aktgjykimi i atakuar të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Paditësja, nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa është e **pa themeltë**.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja përmes të autorizuarit të saj, me dt. 02.03.2022, në gjykatën e shkallës së parë, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore - Drejtoria Komunale e Arsimit për kompensimin e shujtave, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore, Drejtoria e Arsimit paditëses në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit, për 600 ditë gjatë vajtje-ardhjes në punë, në ShFMU “Fazli Graiçevci”, fshati Shipol, Komuna e Mitrovicës, për periudhën kohore nga data 02.03.2019, e deri me datë 22.11.2022, t’ia paguajë shumën prej 420.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë të datës 02.03.2022, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 199.00 Euro.

Nga ana tjetër e paditura, përmes përgjigjes në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses vetëm në mungesë të provave materiale për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, duke propozuar refuzimin e të njëjtës.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të çështjes dhe administrimit të provave në këtë çështje kontestimore, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.288/22, të datës 19.03.2024, me të cilin ka vendosur që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar, e në shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka vendosur se duke ju referuar dispozitës së nenit 8 par.1 dhe nenit 245, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), e lidhur me nenin 35 paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021. Vendimin mbi kamatën e ka mbështetur në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e ka bazuar në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se, përfundimi logjik dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në pjesën vërtetuese është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe se aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me kurrfarë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as atyre nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Aktgjykimi i goditur, në këtë kontest është i qartë dhe i kuptueshëm si në pjesën e arsytimit ashtu edhe në dispozitiv, ku figuron e qartë dhe e kuptueshme mënyra e vendosjes. Dispozitivi është edhe i ekzekutueshëm. E drejta materiale, për të cilën gjykata e shkallës së dytë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, është zbatuar në mënyrë të drejtë, pavarësisht që gjykata e shkallës së parë i është referuar Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 ndërsa është dashur t'i referohet Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, mirëpo meqenëse efekti juridik është i njëjti, atëherë kjo gjykatë vlerëson se vendimi për miratimin e kërkesëpadisë së paditëses është i drejtë në shumën e gjykuar, e që ky aktgjykim është marrë drejtë nga gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, prandaj i njëjti vërtetohet në pjesën që ka të bëjë me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke lënë të pashqyrtuar pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, meqenëse paditësja nuk ka atakuar këtë pjesë me ankesë

Gjykata e Apelit, për arsyet e paraqitura si më lart, në pajtim me nenin 195 par. 1 pika d) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ca.nr.5053/2024 me datë 16.10.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Enes Mehmeti